

VENDIM
Nr. 993, datë 8.11.2013

**PËR TRANSFERIMIN E OBJEKTIT ME EMËRTIMIN “DAMPA E HIRAVE-TEC”, PJESË
PËRBËRËSE E PRONËS “KOMBINATI ENERGJETIK SHA, ELBASAN”, NË PRONËSI TË
BASHKISË ELBASAN TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, shkronja “e”, 5, 6, 7, 8 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme e të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekti me emërtimin “Dampa e hirave-TEC”, pjesë përbërëse e pronës “Kombinati Energjetik sh.a. Elbasan”, të kalojë në pronësi të bashkisë Elbasan të qarkut të Elbasanit, për trajtimin e mbetjeve urbane, sipas planvendosjes dhe formularit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Bashkisë Elbasan i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Objekti i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e komponentëve përbërës të pronës “Kombinati Energjetik sh.a., Elbasan”.

4. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, kryetari i bashkisë Elbasan dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama